

VENDIM
Nr. 295, datë 17.11.2025

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË SHOQATËS “TAKSITË E KLASIT TË PARË” DHE SINDIKATËS SHQIPTARE TË TAKSIVE PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 255, DATË 15.10.2025, “MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KARIKIMIN E MAKINAVE ELEKTRIKE NË PIKAT/STACIONET E KARIKIMIT, ME FUQI TË INSTALUAR MBI 11 kw”

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “ë”, dhe 81, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 144 dhe 146, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16, pika 5, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2732/2 prot., datë 13.11.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesave të Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe të Sindikatës Shqiptare të Taksive për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 255, datë 15.10.2025, Bordi i ERE-s ka vendosur ndër të tjera; miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 22 lekë/kwh për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet me fuqi të instaluar mbi 11 kw dhe aplikimin e çmimit të diferencuar në orarin e pikut, me hyrje në fuqi nga data 1 nëntor 2025.

- Më datë 23.10.2025, ERE-s dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i janë drejtuar dy kërkesa të veçuara nga Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” dhe “Sindikata Shqiptare e Taksive”, të cilat kundërshtojnë vendimin e Bordit nr. 255, datë 15.10.2025, duke kërkuar: 1. Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të tarifës së re deri në zhvillimin e një dëgjimi publik me Shoqatën dhe grupet e tjera të interesit; 2. Rishikimin e tarifës, me qëllim vendosjen e një çmimi preferencial për karikimin e taksive elektrike, si sektor publik me ndikim social dhe mjedisor; 3. Krijimin e një mekanizmi subvencioni ose lehtësie fiskale, për të shmangur kthimin e investimit ekologjik të qindra shoferëve në barrë ekonomike; si dhe parashtime të tjera lidhur me rrezikun e falimentimit dhe ekspozimin financiar të operatorëve të taksive elektrike.

- Me shkresën e datës 24.10.2025, Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” ka kërkuar ndër të tjera: mbajtjen e pandryshuar të çmimit të energjisë për pikat e karikimit të taksive; rishikimi i tarifave të taksimetrit; vendosja e skemave të kompensimit/rimbursimit specifik për taksitë elektrike; heqja e TVSH-së së shërbimit dhe të energjisë për taksitë elektrike; aplikimi i një tarife preferenciale energjie për pikat e karikimit të taksive; krijimi i një skeme rimbursimi për shmangien e rrezikut të falimentimit të kompanive dhe individëve që ofrojnë këtë shërbim publik.

- Me vendimin nr. 271, datë 31.10.2025, Bordi i ERE-s vendosi të refuzojë kërkesat e Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe Sindikatës Shqiptare të Taksive për pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw”.

- Neni 16 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe neni 16 i rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, përcaktojnë se çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s rishikimin e një vendimi brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni, vetëm nëse paraqesin prova të reja që mund të çojnë në një vendimmarrje të ndryshme ose nëse evidentohen gabime materiale. Kërkesa për rishikim nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveç rasteve kur Bordi vendos ndryshe.

- Në kuadër të kësaj procedure, vlerësohet se, në kuptim të nenit 3, pika 7, germa “b” dhe nenit 33, pikat 2 dhe 3 të “Kodit të Procedurave Administrative”, Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” dhe “Sindikata Shqiptare e Taksive”, përfaqësojnë një kategori të përcaktueshme përdoruesish (taksitë elektrike të regjistruara për ushtrim aktiviteti), të cilët mund të preken drejtpërdrejt nga vendimi nr. 255/2025, ndaj legjitimohen si palë në procedurë. Kërkesat e tyre fillestare janë paraqitur brenda afatit 7-ditor ligjor, në përputhje me nenin 16, pika 1 të rregullores nr. 96/2016.

- Vendimi nr. 255, datë 15.10.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 15.10.2025. Për këtë arsye, në referim të kësaj date si moment i marrjes dijeni nga palët, shqyrtimi i praktikës administrative është kryer duke marrë në konsideratë vetëm kërkesat dhe dokumentet e paraqitura brenda afatit ligjor, siç është konstatuar në paragrafin e mësipërm.

- Ndryshe nga kërkesat fillestare, Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” ka depozituar edhe një shkresë shtesë, të protokolluar në ERE më datë 31.10.2025, në të cilën përsëriten shqetësimet lidhur me ndikimin ekonomik të çmimit të miratuar dhe kërkohet rishikimi i tij mbi bazën e kostove të operimit të taksive elektrike. Kjo shkresë është paraqitur jashtë afatit ligjor për depozitim të provave të reja, nuk mund të merret në konsideratë për qëllime të rishikimit të vendimit. Për më tepër, edhe sikur të ishte paraqitur brenda afatit, përmbajtja e saj nuk përbën “provë të re” në kuptimin e nenit 16 të rregullores nr. 96/2016, pasi paraqet vetëm argumente të karakterit ekonomik dhe shqetësime të operatorëve, pa sjellë elemente faktike ose dokumente të reja mbi bazën e të cilave të provohej se vendimi nr. 255/2025 është marrë mbi të dhëna të pasakta, se përmban gabime materiale apo se ekzistojnë rrethana të reja objektive që nuk kanë qenë të njohura në momentin e marrjes së vendimit.

- Nga shqyrtimi i praktikës administrative rezulton se vendimi nr. 255/2025 është marrë në zbatim të parimeve të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, përfshirë parimin e mbulimit të kostove dhe të shmangies së ndërsuvencionimit ndërmjet kategorive të konsumatorëve. Çmimi i miratuar reflekton kostot e shërbimit dhe të disbalancave të shkaktuara në sistem nga pikat e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw, me qëllim garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik dhe të furnizimit universal. Kërkesat e Shoqatës dhe të Sindikatës nuk paraqesin argumente apo prova që të vërtetojnë se këto parime ligjore nuk janë respektuar, apo se vendimi nr. 255/2025 është marrë në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe metodologjinë në fuqi. Kërkesat e Shoqatës dhe Sindikatës nuk vënë në diskutim këto parime ligjore dhe nuk paraqesin argumente apo prova, që të vërtetojnë se vendimi nr. 255/2025 është në kundërshtim me ligjin sektorial ose me metodologjinë në fuqi.

- Në mbështetje të nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 16 të Rregullores nr. 96/2016, rishikimi i një akti administrativ përbën një mjet të jashtëzakonshëm administrativ, i cili lejohet vetëm në prani të rrethanave ose provave të reja, me rëndësi vendimtare për çështjen, që nuk kanë qenë të njohura dhe nuk kanë mundur të njihen gjatë zhvillimit të procedurës që ka çuar në nxjerrjen e aktit.

- Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se parashtrimet e Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe të Sindikatës Shqiptare të Taksive nuk shoqërohen me prova të reja në kuptimin e nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 16 të rregullores nr. 96/2016, por paraqesin kryesisht një analizë të ndikimit ekonomik të vendimit mbi modelin e biznesit të operatorëve të taksive elektrike.

- Sipas nenit 146 të Kodit të Procedurave Administrative, organi që shqyrton kërkesën për rishikim duhet të vlerësojë nëse, në rrethanat aktuale, akti administrativ do të ishte i paligjshëm, vetëm në këtë rast ky akt mund të anulohet, të ndryshohet ose të zëvendësohet. Në rastin konkret nuk rezulton që vendimi nr. 255/2025 të jetë i paligjshëm, as që të jetë marrë mbi bazën e të dhënave të pasakta ose të paplota.

- Për rrjedhojë, kërkesat për rishikim nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 144 dhe 146 të Kodit të Procedurave Administrative dhe në nenin 16 të rregullores nr. 96/2016 për të justifikuar rishikimin e vendimit nr. 255/2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesave të Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe “Sindikatës Shqiptare të Taksive”, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, me qëllim vendosjen e një çmimi preferencial, si të pambështetura në prova të reja, që mund të çonin Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti